



## DEKLARATË për qëndrimin e FIP

mbi lidhjen midis përdorimit të barnave anti-inflamatore jo-steroidale (përfshirë ibuprofen), ACE- inhibitorët, bllokuesit e receptorëve të angiotenzinës (ARBs) e kortikosteroideve, dhe rritjes së rrezikut të infeksionit ose përkeqësimit së sëmundjes me koronavirus / COVID-19

19 Mars 2020

Fédération  
Internationale  
Pharmaceutique

International  
Pharmaceutical  
Federation

Opinione të ndryshme kanë qarkulluar në lidhje me sigurinë e përdorimit të ibuprofenit, ACE- inhibitorëve, bllokuesve të receptorëve të angiotenzinës (ARBs) e kortikosteroideve gjatë pandemisë së koronavirus / COVID-19, duke sugjeruar një rrezik të rritur të infeksionit ose përkeqësimit të sëmundjes. Këto barna përdoren gjerësisht dhe çdo këshillë për të ndaluar përdorimin do të shkaktojë probleme tek pacientët dhe publiku në të gjithë vendet e botës. Ne e dimë që farmacistëve të komunitetit, në veçanti, do t'ju kërkohet të japin këshilla mbi këtë çështje dhe se ato do të ndikojnë në zgjedhjet e trajtimit.

### **Ibuprofen**

Menaxhimi i simptomave të koronavirus / COVID-19 mund të përfshijë përdorimin e antipiretikëve dhe / ose barnave anti-inflamatore për ethe dhe dhimbje të lehta. Enzima konvertuese e angiotenzinës 2 (ACE2) është vërtetuar se ndërmyetëson hyrjen në qeliza të koronavirus / COVID-19 (Markus Hoffmann, 2020), dhe ibuprofen mund të përfshihet në një rritje të shprehjes së ACE2. Sidoqoftë, në praktikën e përgjithshme klinike, ibuprofen ka një efektivitet të provuar prej shumë kohësh në kontrollin e simptomave për të cilat është i indikuar, si në sëmundje infektive të lehta ashtu edhe të rënda. Aktualisht nuk ka prova përfundimtare për të dëshmuar një lidhje të drejtpërdrejtë midis përdorimit të barnave anti-steroidale, anti-



inflatore (përfshirë ibuprofen) dhe rritjes së rrezikut të infeksionit ose përkeqësimit të sëmundjes me koronavirus / COVID-19. Megjithatë, barna të tjera të tilla si paracetamoli (acetaminofeni) mund të konsiderohen për të menaxhuar ethet dhe dhimbjet e lehta në pacientët me COVID-19, nëse konsiderohet e përshtatshme.

### **ACE- inhibitorët dhe bllokuesit e receptorëve të angiotenzinës**

ACE-inhibitorët dhe bllokuesit e receptorëve të angiotenzinës (ARB), të cilët shpesh përdoren në trajtimin e diabetit ose hipertensionit, lidhen shpesh me dukurinë e rritjes së shprehjes së ACE2. Sidoqoftë, nuk ka asnjë provë që të mbështesë pohimin se trajtimi me ACE-inhibitorë ose ARB mund të predispozojë individët për një rrezik më të lartë infektimi me COVID-19 apo rezultate të kundërta nëse ata infektohen me koronavirus / COVID-19. Në koherencë me disa shoqata shkencore dhe profesionale, këshillat e FIP janë që pacientët të vazhdojnë trajtimin e tyre me ACE-inhibitorë ose ARB, përveç rasteve kur këshillohen në mënyrë specifike të ndërpriten nga ekipi i tyre mjekësor.

Fédération  
Internationale  
Pharmaceutique

International  
Pharmaceutical  
Federation

### **Kortikosteroidet**

Kortikosteroidet nuk rekomandohen rutinë në pneumoninë virale apo sindromën akute të crregullimit të frymëmarrjes, dhe duhet të shmangen për shkak të mundësisë për zgjatjen e replikimit viral, siç vërehet te pacientët MERS-CoV, përveç rasteve kur indikohen për arsye të tjera (p.sh., përkeqësimi i sëmundjes pulmonare obstruktive kronike dhe shok septik refraktar, sipas Udhëzimeve të Surviving Sepsis Campaign).

*Ky dokument është përkthyer nga anglishtja nga Orion JUCJA, Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë. Në rast të ndonjë divergjence midis dy teksteve, dokumenti origjinal i Federatës Ndërkombëtare Farmaceutike në anglisht prevalon. E drejta e autorit mbetet ajo e Federatës Ndërkombëtare Farmaceutike.*

*Qëndrimi i FIP bazohet në burimet shkencore të referuara në Udhëzimet e FIP mbi koronavirus / COVID-19, të disponueshme këtu: [www.fip.org/coronavirus](http://www.fip.org/coronavirus).*